



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

DOKUMENTI I RREGULLORES
“LEJE NDËRTIMI PËR ZGJERIM TË RRJETIT NËPËRMJET SHTIMIT TË ANTENAVE
PËR 20 STACIONE BAZË”

MIRATOHEM
KRYETARI I K.K.T.

Z. EDI RAMA

ZËVENDËS KRYETARE I K.K.T.

Znj. EGLANTINA GJERMENI
Ministër i Zhvillimit Urban dhe Turizmit

Znj. MILENA HARITO

Ministër Shteti për Inovacionin dhe Administratën Publike

Miratur me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.1, Datë 03.12.2014

Projektues: “ENERGIA B” sh.p.k.

Administrator : Ioannis Ntoumos



TABELA E PËRMBAJTJES SË DOKUMENTIT TË RREGULLORES

1. Dispozita të Përgjithshme
 - 1.1 Baza Ligjore
 - 1.2 Përshkrim i zonës së studiuar
 - 1.3 Përkufizimi i termave të përdorur
2. Ekstrakte të Instrumentit të Përgjithshëm Vendor (nëse zona ku parashikohet zhvillimi ka një IPV të miratuar në KKT)
 - 2.1 Orientimet dhe Detyrimet që rrjedhin nga IPV
 - 2.2 Rregullat, normat dhe standartet e zhvillimit
 - 2.3 Seti i fragmenteve të hartave të IPV për zonën në zhvillim
3. Analiza e Gjendjes Ekzistuese (elementët ekzistues të territorit)
 - 3.1 Informacion për topografinë e zonës.
 - 3.2 Informacion për burimet natyrore dhe mjediset pyjore (nëse IPV ka parashikuar zona të tilla)
 - 3.3 Informacion mbi zona të mbrojtura natyrore dhe ato të trashëgimisë kulturore dhe historike
 - 3.4 Informacion mbi infrastrukturën ekzistuese të zonës për zhvillim dhe zonave përreth saj
 - 3.5 Përmbledhje dhe gjetjet kryesore të Analizës të Gjendjes Ekzistuese
4. Rregullat e Zhvillimit të Territorit
 - 4.1 Funkcionet dhe aktivitetet e propozuara të strukturave dhe/ose parcelave
 - 4.2 Hapësira e zënë me ndërtesa
 - 4.3 Pamja e Jashtme e Godinave / Trajtimi i Fasadave / Trajtimi i Mbulesave
 - 4.4 Përcaktimin e treguesve për zhvillim për secilën parcelë
 - 4.5 Rregullat e zhvillimit
 - 4.6 Vendqëndrimi për automjetet
5. Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës
 - 5.1 Pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave
 - 5.1.1 Rrjeti Rrugor
 - 5.1.2 Rrjeti i furnizimit me energji elektrike
 - 5.1.3 Impianti i mbrojtjes kundra zjarrit
 - 5.1.4 Impianti i shkarkimit të ujrave të zeza
 - 5.1.5 Impianti i furnizimit me ujë
 - 5.1.6 Impianti i shkarkimit të ujrave të shiut
 - 5.2 Hapësirat e lira dhe të gjelbërta
6. Fazat e Zhvillimit të Lejes së Ndërtimit



7. Relacionin e menaxhimit të inerteve të dala si rezultat i punimeve që do të kryhen për realizimin e projektit.
8. 8. Vlerësimi i Ndikimeve Kryesore në Mjedis
 - 8.1 Ndikimi mbi sipërfaqen e tokës
 - 8.2 Ndikimi mbi ujërat sipërfaqësore
 - 8.3 Ndikimi mbi ujërat nëntokësore
 - 8.4 Ndikimi mbi Biodiversitetin (Flora, Fauna, Habitatet, Pyjet etj)
 - 8.5 Ndikimi mbi menaxhimin e tokës
 - 8.6 Ndikimi mbi Peisazhin
 - 8.7 Ndikimi mbi Zhurmat
 - 8.8 Ndikimi mbi trashëgiminë kulturore dhe arkeologjinë
9. Aneke (Hartat në format A3)



1. Dispozita të Përgjithshme

1.1 Baza Ligjore

Ligji nr. Nr.107/2014 datë 31.07.2014 ‘Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit’

1.2 Përshkrimi i zonës së studiuar

Kompania “Albanian Mobile Communications” AMC për të zgjeruar dhe për të përmirësuar rrjetin e saj të komunikimit elektronik ka parashikuar të instalojë 20 antena celulare me shtrirje në gjithë Shqipërinë, përkatesisht 11 stacione në qytetin e Tiranës, 3 stacione në qytetin e Durrësit, 2 stacione në qytetin e Lezhës, 1 stacion në qytetin e Lushnjës, 1 stacion në qytetin e Shkodrës dhe 2 stacione në qytetin e Vlorës, me të dhëna dhe kordinata dhe adresa si me poshtë:

LISTA E STACIONEVE AMC							
NR.	NR. STACIONIT	EMRI I STACIONIT	TIPI	BASHKIA / KOMUNA	KORDINATAT GJEOGRAFIKE	ADRESA	
1	0057	RRUGA E DURRESIT	Urban	BASHKIA TIRANE	19°47'34.7"	41°20'10.9"	Rr. "Dritan Hoxha", Laprake, Tirane
2	0170	KODRA E DIELLIT NEW	Urban	KOMUNA FARKE/ TIRANE	19°48'01.9"	41°18'36.5"	Rr. "Kodra e Diellit", Selite, Tirane
3	0176	FRESKU 2	Urban	KOMUNA DAJT / TIRANE	19°51'41.8"	41°20'42.3"	Rr. Kombetare Tirane-Mall Dajtit (Linze), Tirane
4	0177	PASKUQAN 2	Urban	BASHKIA KAMEZ	19°46'44.5"	41°21'53.5"	Rruga "Arbërit", Bathore, Bashkia Kamëz
5	0178	MISTO MAME	Urban	KOMUNA KASHAR/ TIRANE	19°46'20.1"	41°19'13.5"	Rr. "Alg Kondi", Tirane
6	0622	AMC SHOP MI	Urban	BASHKIA TIRANE	19°49'00.1"	41°19'34.7"	Rr. "Myslym Shyri", Tirane
7	1510	BOGE	Rural	KOMUNA SHKRELE/ SHKODER	19°36'25.1"	42°22'55.2"	Komuna Shkrel, Rrethi Malësi e Madhe, Shkodër
8	1516	CEKREZ	Rural	KOMUNA ZALL - HERR/ TIRANE	19°48'21.8"	41°24'18.8"	Fshati Cekrez, Komuna Zall-Herr, Tiranë
9	1526	ORIKUMI NEW	Rural	BASHKIA ORIKUM	19°28'32.1"	40°19'22.4"	Orikum, Vlorë
10	1528	HEKURUDHA NEW	Urban	BASHKIA DURRES	19°29'26.0"	41°18'24.0"	Rruga Pavarësia, Durrës
11	1533	DURRES TV	Urban	BASHKIA DURRES	19°26'29.7"	41°18'44.1"	Palatet Auxhesti, Rruga Anastas Durrsaku, Durrës
12	1534	LEZHA NEW	Urban	BASHKIA LEZHE	19°38'41.1"	41°46'32.8"	Lagjia "Beselkija", Lezhe
13	1536	VLORA WEST NEW	Urban	BASHKIA VLORE	19°28'56.5"	40°27'38.9"	Rruga Gjergj Kastrioti (Transbalkanike), Vlorë
14	1540	SHENGJIN CITY	Urban	KOMUNA SHENGJIN	19°35'56.5"	41°48'28.0"	Shengjin, Lezhe
15	0179	BRAKA	Urban	BASHKIA TIRANE	19°48'34.2"	41°20'02.7"	Rruga "Kongresi Tiranës", Tirane
16	0182	MYSLYM SHYRI NEW	Urban	BASHKIA TIRANE	19°48'39.8"	41°19'30.5"	Rruga "Him Koll", Tirane
17	1538	DURRES PISTA	Urban	BASHKIA DURRES	19°26'56.3"	41°18'31.7"	Porti I Durrësit, Durrës
18	1544	LUSHNJA CITY	Urban	BASHKIA LUSHNJE	19°42'29.87"	40°56'15.0"	Lagjia "Xhevdet Nepravishta", Lushnje
19	0161	UNAZA NEW	Urban	KOMUNA KASHAR/ TIRANE	19°47'07.3"	41°19'37.2"	Rruga "Gjergj Elez Alla", Yzberisht
20	0183	VESA CENTER	Urban	BASHKIA TIRANE	19°49' 0.97"	41°19' 8.49"	Rruga "Abdyll Frasher", Tirane

1.3 Përkufizimi i termave të përdorur

- “Rooftop” → Antenë celulare e vendosur në tarracë objekti (zona urbane)
- “Greenfield/landsite” → Antenë celulare e vendosur në tokë (zona rurale)

2. Ekstrakte të Instrumentit të Përgjithshëm Vendor (nëse zona ku parashikohet zhvillimi ka një IPV të miratuar në KKT)

Duke ju referuar faqes zyrtare në web të AKPT-së (www.planifikimi.gov.al) dhe burimeve të tjera nga kompania AMC për zonat, në të cilën do të zhvillohet projekti i ndërtimit të 20 stacioneve AMC, nuk ka IPV të miratuar nga KKT.

2.1 Orientimet dhe detyrimet që rrjedhin nga IPV

Për arsye se nuk ka IPV të miratuar nga KKT për zonat e projektit të instalimit të 20 stacioneve AMC, atëherë nuk ka referencë për orientime dhe detyrime që rrjedhin nga IPV, si rezultat i referohemi vetëm referencave ligjore në fuqi.

2.2 Rregullat, normat dhe standartet e zhvillimit

Rregullat, normat dhe standartet e zhvillimit do të jenë sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, pa referenca në IPV pasi si u përmend më lart nuk ka IPV të miratuar nga KKT për zonat që janë pjesë e projektit të instalimit të 20 stacioneve AMC.

2.3 Seti i fragmenteve të hartave të IPV për zonën në zhvillim

Për arsye të përmendura në pikat 2.1 dhe 2.2 nuk ka harta specifike të IPV për zonat në të cilat kërkohet instalimi i këtyre 20 stacioneve.

3. Analiza e Gjendjes Ekzistuese (elementët ekzistues të territorit)

3.1 Informacion për topografinë e zonës

- Antenat Rooftop, të cilat sipas këtij projekti janë në total 17 antena do të vendosen në tarraca objektsh (godinash), sipas studimit të zonave perkatëse vendosen në objektet që kane kuotën e lartesisë më të madhe për zonën.
- Antenat Greenfield, të cilat sipas këtij projekti janë në total 3 antena, do të vendosen në zona rurale, kodra, larg qendrave të banuara me qëllim për të mbuluar një sipërfaqe më të madhe mbulimi. Pozicioni dhe ndërtimi i këtij tipi antene është parashikuar të jetë në zona me formacione dhe veti shumë të mira fiziko-mekanike të tokës, kjo në ndihmë të ndërtimit të bazamentit të antenës.

3.2. Informacion për burimet natyrore dhe mjediset pyjore (nëse IPV ka parashikuar zona të tilla)

Ky informacion shtrihet vetëm për antenat që janë të ndërtuara në tokë dhe sipas këtij projekti janë vetëm 3 antena të cilat do të ndërtohen në parcela me karakteristike si më poshte vijon :

- Site 1510 Boge do të ndërtohet në parcelën 16/b Ekonomia Pyjore Boge në administrim të Komunës Bogë. Kontrata e Qirasë është nënshkruar ndërmjet operatorit AMC dhe Komunës Bogë si Qiradhënës sipas përcaktimeve ligjore në fuqi në lidhje me dhënien me qira të sipërfaqeve fond pyjor.
- Site 1516 Çekrez do të ndërtohet në një parcelë tokë, e cila është pronë e Komunës Zall Herr dhe nuk është pjesë e fondit pyjor por bën pjesë në fondin e tokave bujqësore.
- Site 1526 Orikumi Neë është projektuar të ndërtohet në një pronë private e llojit tokë bujqësore, zëri tokë me bonitet 7.

3.3 Informacion mbi zona të mbrojtura natyrore dhe ato të trashëgimisë kulturore dhe historike

Sipas informacioneve të marra nga autoritetet si Ministria e Kulturës për çeshtje të zonave arkeologjike dhe ato të trashëgimisë kulturore, për antenat në rooftop rezultojnë të vendosen në godina, si rezultat nuk kanë impakt pamor por edhe për antenat që do të ndërtohen në tokë, të cilat kanë impakt në mjedis konfirmohet se të gjitha zonat e projektit ndodhen jashtë zonave të ruajtura dhe të mbrojtura nga pikpamja e parqeve kombëtare natyrore, arkeologjike apo me trashëgimi kulturore apo historike.

3.4 Informacion mbi Infrastrukturen ekzistuese të zones për zhvillim dhe zonave përreth saj

Infrastruktura ekzistuese në tërësi për zonat e 20 stacioneve është shumë e mirë.

- Për stacionet rooftop përdoret infrastruktura ekzistuese, infrastrukturë urbane, që lidhin zonat midis tyre. Këto rrugë urbane janë rrugë të mirëfillta për përdorim urban, ndërrurban, transport etj.
- Për stacionet greenfield ka infrastrukturë ekzistuese, por ndryshe nga rrugët urbane, rrugët rurale nuk janë të asfaltuara por kanë një bazament përforcues natyror si dhe janë të mirëmbajtura. Në këto stacione përdoret rrjeti ekzistues duke kryer punime për përmirësimin e tij dhe aty ku mungon hapet rrugë e re e cila ndihmon për vajtjen në destinacion. Mirëmbajtja e këtyre rrugëve rurale shërben jo vetëm për operatorin por janë një ndihmë dhe për banorët dhe komunitetin. Gjithashtu, sipas rastit mund të investohet në ndërtimin e rrjetit elektrik, e cila ndihmon në shtrirjen e këtij rrjeti dhe në këto zona.

3.5 Përmbledhje dhe gjetjet kryesore të Analizës të Gjendjes Ekzistuese

Në bazë të studimit të kryer për zonat ku do të ndërtohen 20 stacionet celulare është parë një infrastrukturë, e cila sipas rastit dhe duke kryer investime shtesë sic janë servitutet e kalimit apo ngritja e linjave elektrike ndihmojnë në zbatimin e projektit.

4. Rregullat e Zhvillimit të Territorit

4.1 Funkcionet dhe aktivitetet e propozuara të strukturave dhe/ ose parcelave

Qëllimi i zgjerimit të rrjetit kombëtar të telefonisë celulare AMC është përmirësimi i shërbimit ndaj klientit në zonat e pambulura ose me qëllim përmirësimin e shërbimeve në zona të mbuluara por me kapacitet të ulët ofrimi shërbimi. Për këtë është projektuar ngritja e të paktën 20 stacioneve të reja, 17 stacione urbane dhe 3 stacione rurale me qëllim që të vijnë në ndihmë të rrjetit ekzistues të komunikacionit elektronik .

Stacionet urbane janë struktura metalike tubolare që variojnë me lartësi nga 2 m deri në 8m. Konstruksioni përbëhet nga 3 elementë (në rastin 8m), që do të jenë të parapregatitur dhe do të montohen në vend me anë të dadove dhe bullonave duke shmangur saldimit në vend, i cili mund të sjellë dëme në ambjentet përreth. Antena do të jetë e fiksuar në tarracën e objektit në 3 bazamente beton arme në formë kuboidi, një me permasa 50cm x 50cm ku do të montohet konstruksioni metalik 8m dhe dy bazamente të tjerë me permasa 40cm x 40cm, të vendosura në plan në forme “ L “, ku këto dy të fundit do të shërbejnë për suportin e antenës me anë të ankorave. Pësha dhe forma e antenës është parashikuar dhe projektuar në mënyrë të tillë pas një studimi paraprak të qëndrueshmërisë së godinës dhe tarracës së objektit.

Stacionet rurale janë struktura metalike me lartësi 30 - 33m me elementë të parapregatitur formë "ele", të montura në vend me daço e bullona me qëllim shmangien e ndotjeve në ambientin përreth. Struktura e kullës do të jetë e tillë, ku në bazë do të ketë përmasa 3.2m x 3.2m, e cila vjen duke u ngushtuar me një kënd afërsisht 76 grad deri në lartësinë 3.2m dhe nga kjo kuotë deri në fund të kullës përmasat e kullës do të jenë 0.65m x 0.65m. Vetë antena do të jetë e vendosur në pjesën qendrore të sipërfaqes prej 100 m², e cila do të jetë një bazament për vendosjen e antenës dhe të pajisjeve, i rrethuar nga mure mbajtës beton arme perimetrale. Pjesa e dukshme e murit perimetral do të dalë mbi kuotën natyrale të tokës në lartësinë 1.7m, ndërsa pjesa e brëndshme e murit do të ketë kuotën përfundimtare të saj pas betonimit sa niveli i murit. Për arsye sigurie murit perimetral do ti shtohet një rrjetë metalike me lartësi 1.80m në gjithë perimetrin e saj të rrethimit. Hyrja për në ambientet e antenës prej 100 m² do të bëhet me anë të një dore metalike me gjerësi 3m.

4.2 Hapësira e zënë me ndërtesa

Sipas tipit të antenës hapësira e zënë për ndërtim do të jetë e ndryshme.

Për tipin e antenës rooftop hapësira e pjesës së ndërtimit është 0.6m², e cila përfshin sipërfaqen e bazamenteve beton arme që shërbejnë për fiksimin e antenës dhe ankorave të tyre. Por vetë sipërfaqja për një antenë rooftop varion nga 20 - 35 m² (max), ku përveç sipërfaqes së bazamenteve së bashku me antenën përfshihet gjithashtu edhe hapësira që nevojitet për vendosjen e aparaturave si dhe për hapësirë aksesit gjatë shërbimeve të mirëmbajtjes së antenës.

Për tipin e antenës greenfield sipërfaqja e ndërtimit është një hapësirë prej 100 m², që është sipërfaqja e antenës brenda murit rrethues, ndërsa sipërfaqja totale që përdoret për akses, shesh ndërtimi dhe për mirëmbajtje afatgjate të antenës varion nga 150÷300 m².

4.3 Pamja e jashtme e godinave/ Trajtimi i Fasadave / Trajtimi i Mbulesave

Për antenat e tipit rooftop, të vendosura në tarracë, meqenëse do të vendosen në zona urbane trajtohen në mënyrë të vecantë nga ana pamore në mënyrë që të jetë e integruar me arkitekturën e godinave dhe të jetë në harmoni me mjediset përreth saj. Për këtë pozicionimi i antenës në tarracë është menduar të mos jetë në afërsi të parapetit por më e tërhequr, në drejtim të qendrës së tarracës, duke minimizuar sa më shumë të jetë e mundur impaktin që mund të ketë në fasadën e objektit.

Forma e elementëve metalike të antenës do të jetë elegante dhe moderne duke i shtuar edhe ngjyrë neutrale gjë që e ben atë që të nderhyjë sa më pak në mënyrë negative në ambientet përreth dhe në arkitekturën e objektit.

Për antenat e tipit greenfield duke marrë parasysh vendodhjen e tyre, e cila është jashtë qendrave të banuara, në zona të ngritura, maja kodrash, malesh etj. dhe duke marrë parasysh lartësinë e tyre, do të jetë i tillë që të mos tentojë të fshihet me natyrën, por të dalë në pah.

Lartësia 30m e antenës si dhe mungesa e objekteve të tjera të larta në këtë zonë i jep asaj një rëndësi të vecantë dhe falë strukturës së saj elegante të krijon idenë e një obelisku duke u bërë një objekt jo vetëm funksional por edhe estetik. Jo vetëm kjo, por për këto antena zbatohen dhe rregullat ndërkombëtare në lidhje me ngritjen e strukturave më të larta se mjedisi përreth duke i gjyrosur me ngjyra dalluese.

4.4 Përcaktimin e treguesve për zhvillim për secilën parcelë

Në vijim të informacionit të mësipërm në lidhje me anën teknike të antenave në tokë treguesit për zhvillim për secilën parcelë janë si më poshtë:

NR.	NR. STACIONIT	EMRI I STACIONIT	TIPI	BASHKIA / KOMUNA	LARTESIA	NR. PASURIE	ZONE KADASTRALE	PERSON PRIVAT / SHTET	SIP (M2) PROJEKT
1	1510	BOGE	Rural	KOMUNA SHKRELE/ SHKODER	33	16/b	1237	SHTET	300
2	1516	CEKREZ	Rural	KOMUNA ZALL - HERR/ TIRANE	30	Nr_300 Nr_278/1/1	2961	PRIVAT	300
3	1526	ORIKUMI NEW	Rural	BASHKIA ORIKUM	30	127/4	2832	PRIVAT	150

4.5 Rregullat e Zhvillimit

Realizimi i projektit të ndërtimit dhe instalimit të 20 antenave të komunikimit elektronik të operatorit AMC do të kryhet në përputhje të plotë të rregullave dhe standerteve në fuqi si dhe sipas standarteve ndërkombëtare të zbatuara si nga operatori dhe nga shoqëria zbatuese e projektit. Instalimi dhe ndërtimi i tyre do të kryhet sipas rregullave teknike dhe standarteve më të larta në lidhje me ndërtimin dhe instalimin e objekteve, kullave dhe konstruksioneve metalike duke respektuar politikat për mbrojtjen e mjedisit dhe rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe në respektim të politikave të përgjegjësisë sociale që zbatojnë si operatori dhe zbatuesi i projektit.

4.6 Venqëndrimi për automjetet

Për stacionet e tipit rooftop si vendqëndrime për automjetet gjatë ndërtimit dhe mirëmbajtjes së antenave do të shërbejnë parkimet ekzistuese përreth zonës së antenës.

Ndërsa për stacionet e tipit greenfield do të shërbejë vetë hapësira përreth antenës.

Për site 1510 Bogë, hapësira për vendqëndrim do të jetë 200 m²;

Për site 1516 Çekrez, hapësira për vendqëndrim do të jetë 200 m²;

Për site 1526 Orikumi Neë, hapësira për vendqëndrim do të jetë 50 m²

5.Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës

5.1 Pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave

5.1.1 Rrjeti rrugor

Infrastruktura rrugore për të 20 stacionet është në gjendje shumë të mirë. Për antenat urbane aksesit do të sigurohet nga rrugët si dhe nga shkallët e godinave ku do të ndërtohen antenat. Për antenat rurale aksesit do të sigurohet nga rrugët rurale që janë rrugë ekzistuese me gjerësi deri në 3.5m të cilat shërbejnë si rrugë lidhëse për zonat, transport. Në bazë të këtij studimi nuk është parashikuar hapja dhe ndërtimi i ndonjë rruge të re, por vetëm riparim dhe mirëmbajtje e rrugëve ekzistuese.

5.1.2 Rrjeti i furnizimit me energji elektrike

Sipas rastit të ndërtimit apo instalimit të antenës është parashikuar një projekt i vecantë për lidhjen dhe furnizimin me energji elektrike për çdo stacion si dhe përzgjedhjen e pajisjeve elektromekanike. Qëllimi i projektit për çdo stacion është realizimi i një lidhje e cila nuk do të shkaktojë efekt negativ në përdoruesit ekzistues ose nuk do të ndikohet nga efektet negative të përdoruesve të tjerë ekzistues .

Projekti është hartuar në përmbushje të të gjitha detyrimeve ligjore . Projekti i zbatimit specifikon qartë:

- Pikën e lidhjes së furnizimit me energji elektrike;
- Mënyrën e lidhjes;
- Trasesën e linjës së bashku me të dhënat teknike të dala nga metodika e llogaritjeve përkatëse;
- Përzgjedhjen e paisjeve elektromekanike sipas metodikave përkatëse llogaritëse.

Parashikohen Linja e tensionit të mesëm TM (në rastin e antenave Greenfield) . Në linjen ajrore TM që do të furnizojë kabinën elektrike transformuese të *Stacionit janë bërë studimet në lidhje me :*

1. Kushteve klimaterike ;
2. Qëndrueshmërisë mekanike të përcjellësave, izolatorëve dhe shtyllave për të përballuar nderjet mekanike që shkaktohen nga veprimi i erës, nga pesha e vetë përcjellësit, pesha e akullit në përcjellës etj ;
3. Qëndrueshmërisë elektrodinamike ;
4. Llogaritja e linjës për ngrohje të lejuar ;
5. Llogaritja e linjës për humbje të tensionit ;
6. Përcaktimi i trasesë ;
7. Zgjedhja e tipit të traversave dhe elementeve të tjerë konstruktiv ;
8. Përcaktimi i vendvendosjes së shtyllave ;
9. Përcaktimi i shigjetës së përkuljes për përcjellesin e zgjedhur ;
10. Mbrojtja e linjës nga mbitensionet atmosferike .

- Traseja është llogaritur e tille që :

1. Linja të dalë sa më e shkurtër ;
2. Të mos paraqesë rrezik për njerëzit dhe ekonominë ;
3. Tu shmanget zonave që rrezikojnë punën normale të saj (e parë në kompleks edhe me problemet e pronësisë ;
4. Të jetë e lehtë për tu kontrolluar dhe mirëmbajtur.

Gjatë projektimit të linjës është pasur parasysh që ajo të mos kalojë mbi objekte me rrezik zjarri, por të vendoset ndaj tyre më larg se 1.5 herë e lartësisë së shtyllave nga toka . Bazuar në kriteret dhe standartet e miratuara largësia midis shtyllave varion nga 40-60m duke përdorur në këtë zonë traversa tip 'Y' me dopio izolatorë rezistentë dhe të qëndrueshme për këto kategori zonash në përputhje me normat teknike.

Kabina elektrike transformuese TM/TU. Njyra transformuese do të jetë e tipit ajror (me shtylla). Në projekt është paraqitur varianti me shtyllë mbështetëse. Në këtë variant jepet kabina elektrike shtyllore me dy shtylla sipas standartit teknik të miratuar nga KESH sha. Ky tip kabine është përzgjedhur dhe projektuar në përputhje me kërkesat e rregullores së shfrytëzimit, sigurimit teknik dhe standarteve të normave IEC. Paisjet janë përzgjedhur sipas gjithë kërkesave dhe normave të IEC ku në vecanti specifikimet teknike që duhet të plotësojë çdo nyje e kabinës transformuese jepet në kapitullin e specifikimeve teknike Ndarësi do të realizohet me bllokim mekanik si në hapje ashtu edhe në mbyllje. Largësia nga toka e komandimit të ndarësit do të jetë ≥ 2000 mm me të drejtë manovrimi vetëm nga persona të autorizuar . Në këtë kabinë janë vendosur paisje tokëzimi të cilat shërbejnë 1) Për plotësimin e kushtit të tokëzimit të pikës neutrale 2) Për sigurimin e Paisjeve dhe të njerëzve që punojnë me këto paisje. Tokëzimi i punës i kësaj kabine do të realizohet me 8 copë elektroda ku vlera e tokëzimit duhet të jetë $\leq 4 \Omega$, në rast të kundërt do të shtohet numri I elektrodave për të arritur vlerën e rekomanduar.

Për mbrojtjen e njerëzve dhe të paisjeve përdoren shkarkuesat për mbrojtje nga mbitensionet atmosferike. Këto mbitensione mund të lindin si pasojë e goditjes së drejtëpërdrejtë të rrafesë në elementin e rrjetit elektrik ashtu dhe si pasojë e tensioneve të induktuara në rrjet kur pranë tyre ka shkarkime atmosferike. Për këtë janë zgjedhur shkarkuesat elektrik me oksid zinku (ZnO) veshje polimerike, klasa I për rrjet TM .

3. Sigurimi teknik : Në çdo shtyllë të linjës elektrike TM dhe tek nyja transformuese vendosen tabela në lartësi 3m nga toka « NDAL TENSIONI I LARTE », punonjësi që do të mirëmbajë dhe do të shfrytëzojë këtë instalim duhet të jetë i instruktuar për rregulloren e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për këto instalime

Ana sekondare e kabinës elektrike transformuese

Në projektin e saj përfshihen

- Përcaktimi i rrymave të LSH në zbarat e TU;
- Skema e panelit TU;
- Zgjedhja e çelësve automate për fuqinë e LSH dhe rrymën nominale;
- Seksioni i përcjellësit që lidh sekondarin e Transformatorit me panelin TU;
- Realizimin e tokëzimit të punës dhe mbrojtjes si dhe seksionet e përcjellësve përkatës.

Linja e TU (në rastin e antenave rooftop)

Realizohet me linje kabllore. Projekti i saj përfshin qëllimin i cili, parashikon:

- Tipin dhe seksionin e kabllit;
- Trasenë ku linja nëntokësore do të kalojë;
- Kanalën përkatës dhe kërkesat për shtrirjen e kabllit dhe mbrojtjen e tij nga dëmtimet gjatë shfrytëzimit;
- Si trase linje rekomandohet kalimi në distanca sa më të shkurtra duke synuar në anët e rrugëve. Në intersektimet e rrugëve shtrohen tuba tip xingato, brenda të cilit vendosen tub PVC, konform kushteve teknike të ftohjes dhe atyre të KTZ;
- Në kufirin e pronësisë do të vendoset matësi i energjisë elektrike të CEZ e pajisur me limitatorin përkatës.

5.1.3. Impjanti i mbrojtjes kundra zjarrit

I gjithë territori i vendosjes së antenave është i siguruar me masa mbrojtëse, është i rrethuar, i ndricuar dhe i siguruar gjatë gjithë kohës. Mjediset e antenës dhe territori rreth objektit janë të kontrolluara në çdo kohë me kamera vëzhgimi. Hyrja për në objektin e antenave është e kufizuar dhe vetëm në ato raste kur bëhet riparimi i saj. Antena është projektuar me elementë konstruktiv të pa djegshëm. Sipas karakteristikave të vendit, terracë, tokë dhe natyrës së veprimtarisë që do të kryhet dhe elementeve konstruktiv të godinave ku është projektuar për tu instaluar antena për të 20 stacionet plotësohen kërkesat bazë të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi.

Për kushtet e paraqitura në çdo stacion, qoftë në godinë qoftë në tokë si dhe infrastrukturën përreth tyre, plotësohen largësitë e mbrojtjes nga zjarri të përcaktuara në normat përkatëse. Duke qenë se aparaturat që do të përdoren për secilin stacion janë bashkohore, me garanci e masa sigurie të një niveli shumë të lartë, panelet elektrike dhe pajisjet e energjisë janë projektuar të jenë të kompletuara e të siguruara me elemente antizjarr, me elemente të togëzimit dhe rrafepritëse. Në rast zjarri automjetet dhe pajisjet zjarrfikëse mund të afrohen te ndërtesa e antenës të paktën nga dy anët e saj. Forcat dhe mjetet

zjarrfikëse e ato të shpëtimit i kanë hapësirat e nevojshme për të vepruar lirshëm për shpëtimin e njerëzve dhe për shuarjen e zjarrit, nëse krijohet një situatë e tillë. Kjo vlen edhe për stacionet rurale ku hapësirat e nevojshme në rast zjarri, të cilat do të jenë të dimensioneve të vogla, janë shumë mirë të aksesueshme.

5.1.4 Impjanti i shkarkimit të ujrave të zeza

Si për antenat në tarracë dhe ato në tokë nuk do të ketë ndikime negative në kanalizimet e ujërave të zeza. Kjo edhe sipas pëlqimit të dhënë nga Institucioni i Kanalizimit të Ujërave të Zeza. (Dokumenti “ Lidhja me Infrastrukturën inxhinierike “), pasi këto konstruksione nuk parashikojnë përdorimin e kësaj infrastrukture.

5.1.5 Impjanti i furnizimit me ujë

Si për antenat në tarracë dhe ato në tokë nuk do të kemi ndikime negative në rrjetin e ujësjellësit. Kjo edhe sipas pëlqimit të dhënë nga Institucioni i Ujësjellësit. (Dokumenti “ Lidhja me Infrastrukturën inxhinierike “) pasi këto konstruksione nuk parashikojnë përdorimin e kësaj infrastrukture.

5.1.6 Impjanti i shkarkimit të ujrave të shiut

Si për antenat në tarracë nuk do të kemi ndikime negative në impjantin e shkarkimit të ujërave të shiut. Për antenat në tokë do të krijohen ulluqe rreth e përqark sipërfaqes së antenës për të mbledhur shkarkimin e ujrave të shiut, të cilat do të derdhen me anë të sistemit të tubave plastik në kanalizimet më të afërme të zonës. Ndërsa në antenat në tarracë ky sistem është i parashikuar nga vetë godina si pjesë e saj që në ndërtimin e saj.

5.2 Hapësirat e lira dhe të gjelbërta

Subjekti ndërtues që do të marrë përsipër ndërtimin e të gjitha stacioneve nuk do të ushtrojë dëme në ambjentin përreth duke demtuar faunën. Edhe pas përfundimit të funksionit të këtyre antenave, që do të thotë ku në të ardhmen pas demtimit të tyre, kompania AMC do të marrë përsipër rehabilitimin e zonave, kthimin e të gjitha zonave në gjendjen e tyre të mëparshme. Duke qenë se ky aktivitet nuk parashikon hapësira të gjelbërta, si operatori AMC edhe shoqëria zbatuese ndjekin politika për krijimin e hapësirave të gjelbërta.

6. Fazat e Zhvillimit të Lejes së Ndërtimit

Faza e ndërtimit të këtyre stacioneve përfshin një hapësirë kohore prej një muaj për secilin stacion, gjithë projekti i zbatimit për ndërtimin e tyre është parashikuar të përfundojë brenda vitit 2015.

7. Relacionin e menaxhimit të inerteve të dala si rezultat i punimeve që do të kryhen për realizimin e projektit.

Ndryshe nga stacionet urbane, stacionet rurale kërkojnë një volum gjermim mbushje për të krijuar sheshin për ndërtimin e antenës. Volumet e gjermimit për këto stacione greenfield janë 47 m³ (me dimensione 11.6m x 11.6m x 0.35m). Dherat e gjermuar do të përdoren për nivelimin e sheshit të ndërtimit. Një pjesë tjetër e materialit do të përdoret për të rehabilituar ambjentin përreth antenës ose për rehabilitimin e rrugës ekzistuese kur është e nevojshme.

8. Vlerësimi i Ndikimeve Kryesore në Mjedis

Nga vetë natyra e shërbimeve të telekomunikacionit, kompania AMC ka ndikim relativisht të ulët tek mjedisi. Objektivi i kompanisë është të mos ketë ndikim negativ mbi mjedisin, apo të minimizojë efektet e mundshme, të cilat krijohen në mënyrë të paevitueshme nga çdo aktivitet njerëzor. Bazuar në

Ligjin Nr. 10440, datë 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", ndërtimi i antenave në tokë vlerësohet se ka ndikim jo shumë të madh në mjedis ndryshe nga antenat e instaluara në godina të cilat nuk sjellin ndikim në mjedis sipas përcaktimeve të ligjit të sipërpërmendur. Bazuar në Shtojcën II të ligjit, ndërtimi i antenave në tokë klasifikohet si aktivitet që i nënshtrohet Procedurës Paraprake të Ndikimit në Mjedis dhe pajiset me Vendim për VNM Paraprake. Specifikisht klasifikohet në: Pika 10. *Prodhimë infrastrukturore/a) Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale;*

Qëllimi i këtij aktiviteti është ndërtim-funksionimi i rrjetit të lëvizshëm të komunikimeve publike (GSM), për shërbimin publik telefonik të lëvizshëm tokësor nëpërmjet frekuencave E-GSM 900 GSM 1800 MHz dhe UMTS 2100 MHz", duke ndërtuar një platformë për montimin e një antene tip "Greenfield". Nga 20 stacione të reja në total për tu ndërtuar pjesë e këtij projekti, vetëm 3 stacione parashikohen të ndërtohen në tokë, të cilat janë pajisur me VNM paraprake të miratuara përkasisht nga organet përkatëse Ministria e Mjedisit dhe QKL.

8.1 Ndikimi mbi sipërfaqen e tokës

Nga zhvillimi i aktivitetit nuk kemi humbje të tokës, rrëshkitje të dherave, erozion etj. Asnjë lloj mbetjeje nuk do të shkarkohet në tokë. Mbetjet që do të gjenerohen nga aktiviteti i përgjithshëm i personelit apo ato të tipit ambalazh, shkon në vendet e caktuara nga pushteti lokal.

8.2 Ndikimi mbi ujërat sipërfaqësore

Bazuar në Raportet e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të miratuara nga Ministria e Mjedisit të tre stacionet landsite 1) Site 1510 BOGA 2) Site 1516 ÇEKREZI 3) Site 1526 ÒRIKUM do të ndërtohen larg burimeve ujore sipërfaqësore si lum, përrua, liqen etj, dhe si rezultat këto ndërtime nuk do të kenë asnjë ndikim në ujërat sipërfaqësore.

8.3 Ndikimi mbi ujërat nëntokësore

Edhe për burimet nëntokësore aktiviteti i ndërtimit të tre stacioneve të sipërpërmendura të studuar me zonën ku ato do të ndërtohen nuk përbën rrezik, pasi ky aktivitet nuk kërkon përdorim uji.

8.4 Ndikimi mbi Biodiversitetin (Flora, Fauna, Habitatet, Pyjet etj)

Objektet do të ndërtohen në toka të pafrytshme, të cilat nuk shquhen për pasuri të veçantë të botës bimore e shtazore. Nga ky aktivitet nuk do të vijnë shqetësime si humbje të bimësisë, prishje habitatesh, ekosistemesh etj. Nuk do ketë prerje pemësh apo humbje të bimësisë.

8.5 Ndikimi mbi menaxhimin e tokës

Për të tre stacionet që do të ndërtohen në tokë është parashikuar Plani i Menaxhimit Mjedisor (PMM) për secilin ndërtim. Qëllimi kryesor i PMM është të sigurojë një proces të drejtë gjatë projektimit, ndërtimit dhe operimit në terma të impaktit dhe masave parandaluese të vlerësuara në Seksionin nr.6

PMM dhe Programi i Monitorimit Mjedisor do të sigurojë implementimin e rekomandimeve parandaluese dhe të parandalojë ndonjë ndikim të mundshëm mjedisor të anashkaluar në raportin e VNM-së.

Pavarësisht nga kjo, PMM stimulon procedurat dhe rregullat që duhet të ndiqen gjatë ndërtimit dhe për më shumë gjatë operimit të këtyre antenave. Plani i menaxhimit vlerësohet në tre faza kryesore.

Fazën e projektimit

Gjatë kësaj faze është e rëndësishme identifikimi i pronarëve, fazë kjo tashmë e përfunduar ku të gjithë pronarët janë identifikuar dhe janë lidhur kontratat. Si dhe një prej ideve kryesore është shmangia e konflikti midis mjedisit natyror dhe menaxhimit të tokës, ku dhe ky proces tashmë ka përfunduar me identifikimin e çdo site dhe realizimi i planimetrimëve përkatëse për këto site.

Fazën e ndërtimit

Punimet e ndërtimit për çdo site do të zbatohen nën mbikëqyrjen e supervizorit të përcaktuar nga kontraktori.

Për të shmangur dëmtime apo ndërhyrje në zona të mbrojtura si trashëgimi kulturor është konsultuar me Institutin e Monumenteve të Kulturës të cilët megjithëse këto zona janë jashtë zonave të mbrojtura do të jenë prezent gjatë punimeve të fazës së parë të gërmimit dhe hapjes së gropës për të identifikuar nëse mund të ketë zbulime të reja që nuk janë hedhur në listën e zonave të trashëgimise kulturore.

Plani i punës dhe i punimeve do të ndërmerret nga kontraktori para se të fillojë në terren punimet specifike, bazuar në kapacitetin e kontraktorit (numri i punonjësve, numri dhe cilësia e mjeteve dhe mekanizmave që disponojnë për këtë proces). Punimet e ndërtimit duhet të sistemohen dhe programohen në mënyre të tilla që të minimizojnë ndikimin në mjedis.

Fazën e operimit

Në lidhje me rrezatimin jonizues të linjave elektrike, intensiteti i fushës elektrike në një lartësi 1.8m nga sipërfaqja e tokës, me një varg telesh me lartësi të kalueshme, nuk e kalon 5kV/m dhe me 1kV/m jashtë zonës buferike të sigurisë. Të gjitha antenat duhet të respektojnë përcaktimet sipas raporteve të shpërndarjes së rrezatimit elektromagnetik të kryera nga ekspertet dhe të miratuara përkatesisht nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet.

Për kontenjeret që janë pjesë e çdo antene duhet të jenë të pajisur me zjarre kontrollues, sistem ventilimi dhe gjenerator kur është e nevojshme, rrufe pritës, dhe sinjali i paralajmërimit.

8.5.1. Rekomandimet që do të ndiqen gjatë këtyre fazave janë si më poshtë:

- Të kryhet menaxhim i integruar i mbetjeve të ngurta duke i seleksionuar dhe menaxhuar nëpërmjet kontratave kontraktuale me Njësinë e Qeverisjes Vendore ose subjekte të licensuar për këtë qëllim.
- Të mos hidhet asnjë mbetje e ngurtë ose e lëngët në mjedisin ujor dhe atë tokësor të zonës.
- Të kryhet monitorimi i treguesve mjedisor dhe raporti periodik i vetëmonitorimit dhe të dorëzohet në DRM përkatëse çdo tre muaj për periudhën e punimeve të ndërtimit.
- Mirëmbajta dhe gjelbërimi në mënyrë të vazhdueshme i mjedisëve përreth objekteve duke ruajtur një imazh të këndshëm dhe për rritjen e vlerave të rekreacionit të këtyre objekteve.
- Subjekti të jetë në dijeni të kuadrit ligjor për mjedisin dhe të ndryshimeve të tij.

8.6 Ndikimi mbi Peisazhin

Territoret në studim nuk janë përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në zonë të mbrojtur apo zonë buferike, të cilat ruhen në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi. Zonat në studim nuk bëjnë pjesë në zonat e mbrojtura me interes ndërkombëtar apo të çënojnë ndonjë nga konventat e nënshkruar.

8.7 Ndikimi mbi Zhurmat

Aktiviteti i ndërtimit dhe vete antenat nuk prodhojnë zhurma dhe nuk kanë asnjë ndikim.

8.8 Ndikimi mbi trashëgiminë kulturore dhe arkeologjinë

Projekti i ndërtimit të antenave, do të jetë jashtë zonave me trashëgimi kulturore dhe arkeologjike si dhe punimet e gërmimit në tokë do të ndiqen nga specialistë të Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare.

9. Aneks (Hartat në format A3)


1. Harta e planvendosjes së 20 stacioneve AMC
2. Lista e 20 stacioneve me të gjitha të dhënat
3. Plani topografik (tipi rooftop)
4. Planimetria + Projekti (tipi rooftop)
5. Plani topografik (tipi greenfield)
6. Planimetria + Projekti (tipi greenfield)



LISTA E STACIONEVE AMC

NR.	NR. STACIONIT	EMRI I STACIONIT	TIPI	BASHKIA / KOMUNA	LARTESIA	KORDINATAT GJEOGRAFIKE		ADRESA	PERSON PRIVAT / SHTET	SIP (M2)
1	0057	RRUGA E DURRESIT	Urban	BASHKIA TIRANE	8	19°47'34.7"	41°20'10.9"	Rr. "Dritan Hoxha", Laprake, Tirane	PRIVAT	30
2	0170	KODRA E DIELLIT NEW	Urban	KOMUNA FARKE/ TIRANE	3	19°48'01.9"	41°18'36.5"	Rr. "Kodra e Diellit", Selite, Tirane	PRIVAT	30
3	0176	FRESKU 2	Urban	KOMUNA DAJT / TIRANE	8	19°51'41.8"	41°20'42.3"	Rr. Kombetare Tirane-Mali Dajtit (Linze), Tirane	PRIVAT	30
4	0177	PASKUQAN 2	Urban	BASHKIA KAMEZ	8	19°46'44.5"	41°21'53.5"	Rruga "Arbërit", Bathore, Bashkia Kamëz	PRIVAT	30
5	0178	MISTO MAME	Urban	KOMUNA KASHAR/ TIRANE	8	19°46'20.1"	41°19'13.5"	Rr. "Alqi Kondi", Tirane	PRIVAT	35
6	0822	AMC SHOP MI	Urban_Mi	BASHKIA TIRANE	2	19°49'00.1"	41°19'34.7"	Rr. "Myslym Shyri", Tirane	PRIVAT	-
7	1510	BOGE	Rural	KOMUNA SHKRELE/ SHKODER	33	19°36'25.1"	42°22'55.2"	Komuna Shkrel, Rrethi Malësi e Madhe, Shkodër	SHTET	300
8	1516	CEKREZ	Rural	KOMUNA ZALL - HERR/ TIRANE	30	19°48'21.8"	41°24'18.8"	Fshati Cekrez, Komuna Zall-Herr, Tiranë	PRIVAT	300
9	1526	ORIKUMI NEW	Rural	BASHKIA ORIKUM	30	19°28'32.1"	40°19'22.4"	Orikum, Vlorë	PRIVAT	150
10	1528	HEKURUDHA NEW	Urban	BASHKIA DURRES	8	19°29'26.0"	41°18'24.0"	Rruga Pavarësia, Durrës	PRIVAT	35
11	1533	DURRES TV	Urban	BASHKIA DURRES	10	19°26'29.7"	41°18'44.1"	Pallatet Auxhësti, Rruga Anastas Durrsaku, Durrës	PRIVAT	30
12	1534	LEZHA NEW	Urban	BASHKIA LEZHE	8	19°38'41.1"	41°04'32.8"	Lagjia "Beselidhja", Lezhe	PRIVAT	30
13	1536	VLORA WEST NEW	Urban	BASHKIA VLORE	8	19°28'56.5"	40°27'38.9"	Rruga Gjergj Kastrioti (Transballkanike), Vlorë	PRIVAT	30
14	1540	SHENGJIN CITY	Urban	KOMUNA SHENGJIN	8	19°35'56.5"	41°04'28.0"	Shengjin, Lezhe	PRIVAT	30
15	0179	BRRAKA	Urban	BASHKIA TIRANE	8	19°48'34.2"	41°20'02.7"	Rruga "Kongresi Tiranes", Tirane	PRIVAT	30
16	0182	MYSLYM SHYRI NEW	Urban	BASHKIA TIRANE	8	19°48'39.8"	41°19'30.5"	Rruga "Him Kolli", Tirane	PRIVAT	20
17	1538	DURRES PISTA	Urban	BASHKIA DURRES	Shtylle Ndricimi (Iart. 20m)	19°26'56.3"	41°18'31.7"	Porti I Durresit, Durres	SHTET	--
18	1544	LUSHNJA CITY	Urban	BASHKIA LUSHNJE	12	19°42'29.87"	40°56'15.0"	Lagjia "Xhevdet Nepravishta", Lushnje	PRIVAT	30
19	0161	UNAZA NEW	Urban	KOMUNA KASHAR/ TIRANE	8	19°47'07.3"	41°19'37.2"	Rruga "Gjergj Elez Alia", Yzberisht	PRIVAT	35
20	0183	VESA CENTER	Urban	BASHKIA TIRANE	3.2	19°49' 0.97"	41°19' 8.49"	Rruga "Abdyl Frasherit", Tirane	PRIVAT	20

Steel reinforcement concrete for supporting wall and ring fence wall
 Bazamenti b/a per murin mbajtes dhe murin rrethues




SPECIFICATION OF STEEL FOR HT-Ring Fence Wall
 TE DHENAT E HEKURIT PER MURIN RRETHUESI

Rebar	Ø mm	NR (pcs)	L(m)	Ltot (m)
1	8	165	1.70	280.5
2	10	16	9.90	159
SUMMARY				
Ø mm	Ltot (m)	Weight (kg/m)	Weight (kg)	
8	280.5	0.395	110.8	
10	159	0.617	98.10	
				TOTAL 209 KG

TOTAL 209 KG

Rebar	Ø mm	NR (pcs)	L(m)	Ltot (m)
①	10	200	3.40	680
②	8	200	2.20	440
③	8	120	0.40	48
④	10	32	9.90	317
⑤	8	56	9.90	555
SUMMARY				
Ø mm	Ltot (m)	Weight (kg/m)	Weight (kg)	
8	1043	0.395	412	
10	997	0.617	615	
				TOTAL 1027 KG




TOTAL 1027 KG



DATE	EMRI	EMERTIMI	Shk
15 / 05 / 14	ING. DHIMTER DERVISHI	SITE 1516 CEKREZ	
	ARK. RUDIN DURAJ	DETAJE TE ANTENES	FLETA
			P01



PILLAR 1,30x1,00x2,40m





outside view

ENERGIA B sh.p.k.
 NIPT K 3-1714095 E
 Autostrada Tirane - Dures
 KASHTAR, ALBANIA
 Kilometri 6

DATE	EMRI	EMERTIMI	Shk
15/05/14	ING. DHIMETER DERVISHI	SITE 1516 CEKREZ	
	ARK. RUDIN DURAJ	DETAJE TE PILARIT	
			FILETA
			P01




STEEL REINFORCEMENT FOR RING FENCE WALL
DETAJE TE HEKURRT PER MURIN RRETHUES



DATE	EMRI	EMERTIMI	Shk
15 / 05 / 14	ING. DHAMTER DERVISHI		
	ARK. RUDIN DURAJ		
			
		ENERGIA B Sh.p.k. NIPT K 31714065 E Autostrada Tirane - Dures, Kilometri 6 KASHAR, ALBANIA	
		DETAJE TE MURIT RRETHUES	FILETA P01
		A3	

SITE PLAN OF "1540 SHENGJINI CITY" STATION


SH 1 : 500



ANTENNA NATIONAL COORDINATES		
N=4631352.186	E=4383747.066	Z=50.10
ANTENNA WGS84		
N = 41° 48' 27.54"	E = 19° 35' 58.21"	H = 50.10

TITULLI		Rilevim topo-gjeodezik per antenen 1540 SHENGJIN CITY	
POROBITESI	ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS 	Adresa: Rruga "Shengjin - Kune", Shengjin, Lezhe	
PUNOI	ENERGIA B SH.P.K.	Ing. topograf: ARIAN SHTEMBARI	Shkalla 1:500 Data 18/08/2014


ENERGIA B sh.p.k.
 NIPT K 31714065 E
 Autostrada Tirane - Durres, Kilometri 6
 KASHAR, ALBANIA




DATE	EMRI	Shengjin City (1540)	Shk
15/05/14	ING. DHIMITER DERVISHI		
	ARK RUDIN DURAJ	Dr. Nr.	FLETA
		PLANIMETRIA	P01



ENERGIA B sh.p.k.
 NIPIT K 3-17140055 E
 Autostrada Tirane - Dures, Kilometri 6
 KASHAR, ALBANIA

1:10;1:20



ENERGIA B sh.p.k.
 NIPT K 31714065 E
 Autostrada Tirane - Durres , Kilometri 6
 KASHAR , ALBANIA

DATE	EMRI
15 / 05 / 14	ING. DHIMITER DERVISHI
	ARK. RUDIN DURA




EMERTIMI
1540 SHENGJIN CITY
Dr. Nr.
DETAJE



1:10;1:20



PHASING

- 1 - SE DECOPELTEAZA PANA LA NIVELUL PLANSEULUI TOATE IZOLATIILE.
- 2 - THE REINFORCED CONCRETE SLAB SURFACE IS ROUGHENED WITH THE BORING MILLS DRILLSE BUCIARDEAZA SUPRAFATA PLACII DE B.A. CU BURHIIUL MASINII DE GAURIT
- ASTFEL INCAT SA SE OBTINA O SUPRAFATA RUGOASA.
- 3 - SE REALIZEAZA GAURILE IN PLACA/GRINDA DE BETON ARMAT.
- 5 - SE CURATA GAURILE CU JET DE CU AER SAU CU PERIILE SI POMPA DIN TRUSA HILTI CAT IAR APOI SE CURATA BAZA DECOPELTARI.
- 6 - SE POZEAZA CARTUSELE CU RASINA HILTI R500/330/1 (MONTAJ IN CONDITII UMEDE) SAU HIT-HY/330 (CONDITII USACATE DE MONTAJ) IN GOLURILE CREATE SI SE INTRODUC ARMATURILE VERTICALE (Poz.2) CU CAPETELE IN GAURI.
- 7 - SE POZEAZA BULOANELE DE ANCORAJ SI SE PRIND CU PLACA DE CENTRARE SI SE VERIFICA DISTANTELE DINTRE GRUPURILE DE BULOANE DE ANCORAJ.
- 8 - SE COFREAZA PARTEA SUPERIOARA (DEASUPRA IZOLATIILOR).
- 9 - SE TOARNA BETONUL (C16/20) CU GRANULATIE MICA.
- 10 - DECOFRAREA SI MONTAJUL CATARGULUI SI A CONTRAVANTUIRILOR DUPA MINIM 2 ZILE IN CONDITII NORMALE DE TEMPERATURA.
- 11 - DUPA MONTAJUL CONFECTIEI METALICE SE REFACE HIDROIZOLATIA PE CAT POSIBIL CU ACELISI MATERIAL DE PE AMPLASAMENT URMARINDU-SE O ADERENTA CAT MAI BUNA INTRE STRATUL VECHI SI CEL NOU DE HIDROIZOLATIE.



POZ.	QUANT.	ASSEMBLY CODE	DESCRIPTION	MATERIAL	WEIGHT
1	3	Stirrup		PC 52	0.412 kg
2	4	Base anchor bolt		OL 37 STAS 500/2	1.592 kg
3	4	Base anchoring reinforcement		PC 52	1.407 kg
4	4	MN20	Graver washer	ARC 6A - STAS 795	0.016 kg
5	4	Nut M20	Hexagonal nut	gr.8 STAS 2700/4	0.075 kg
6	4	Washer A20	Plain washer	OL34 STAS 500/2	0.017 kg
7	4	Nut M20	Hexagonal nut	gr.8 STAS 2700/4	0.075 kg

Weight= 13.964 kg



POZ.	QUANT.	ASSEMBLY	DESCRIPTION	MATERIAL	WEIGHT
1	3	Stirrup		PC 52	0.412 kg
2	4	Base anchoring reinforcement		PC 52	1.407 kg
4	4	Bracing anchor bolt		OL 37 STAS 500/2	1.019 kg
5	4	MN16	Graver washer	ARC 6A - STAS 795	0.010 kg
6	4	Nut M16	Hexagonal nut	gr.8 STAS 2700/4	0.040 kg
7	4	Washer A16	Plain washer	OL34 STAS 500/2	0.011 kg
8	4	Nut M16	Hexagonal nut	gr.8 STAS 2700/4	0.040 kg


Masa= 11.344 kg

ENERGIA B sh.p.k.
 NIPT K 31714065 E
 Autostrada Tirane - Durres , Kilometri 6
 KASHAR , ALBANIA

DATE	EMRI	EMERTIMI	Shk
15 / 05 / 14	ING. DHIMITER DERVISHI	1540 SHENGJIN CITY	
	ARK. RUDIN DURA	Dr. Nr.	FLETA
		DETAJE	
		A3	P01

SITE PLAN OF " 1516 CEKREZE" STATION

SH 1 : 1000




ANTENNA NATIONAL COORDINATES		
N=4586404.60	E=4400272.64	Z=204.25
ANTENNA WGS84		
N = 41° 24' 18.9"	E = 19° 48' 21.3"	H = 205.08

TITULLI			
Rilevim topo-gjeodezik per antenen 1516 CEKREZ			
PROJEKTESI	ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS 	Adresa: Fshatë Cekreze, Komuna Zall Herr, Tirane	
PUNCI	ENERGIA B SH.P.K.	Ing. topograf : ARIAN SHTEMBARI	Shkalla 1:1000 Data 18/08/2014



ENERGIA B sh.p.k.
 NIPT K 31714065 E
 Autostrada Tirane - Durres , Kilometri 6
 KASHAR , ALBANIA

PLANI I STACIONIT 1516 CEKREZ



ENERJIA B sh.p.k.
 NIPT K 31714065 E
 Autostrada Tirane - Durres, Kilometri 6
 KASHAR, ALBANIA

DATE	EMRI	EMERTIMI
15/05/2014	ING. DHIMITER DERVISHI	1516 CEKREZ
	ARK. RUDIN DURA	
		PLANIMETRIA E ANTENES
Madhesia fletes A3		



60	48	2.29	.55	2.17	3.31	.60
1.00	2.52	.80	1.36	.80	2.52	1.00
10.00						

ENERGIA B sh.p.k.
 NIPT K 31714065 E
 Autostrada Tirane - Durres , Kilometri 6
 KASHAR , ALBANIA

DATE	EMRI	EMERTIMI	SHKALLA
15/05/2014	ING. DHIMITER DERVISHI	1516 CEKREZ	
	ARK. RUDIN DURA		
		PAMJE TE ANTENES	
			Madhesia fletes A3